




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbëno/Prodato Received/Delivety	19.01.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPOMSTER	216/2021		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.409/2020**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga:** Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.409/2020 të datës 09.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Pasomë komuna e Vushtrrisë, kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike “Transferim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 19.01.2021, mori këtë

**V E N D I M**

**I.Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.409/2020 e datës 09.12.2020 e parashtruar nga ankuesi.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi më datë 09.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3034/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin për shfuqizimin e Vendimit me Nr. 128/20 të datës 10.02.2020 të Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, respektivisht kthim në vendin e punës “Zyrtar për Çështje Juridike Administrative” në Drejtorinë e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, më datë 16.12.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Komuna e Vushtrrisë. Këshilli më datë 30.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Vushtrrisë.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:**Ankesën e datës 09.12.2020 me numër protokolli 3034/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për kthim në vendin e punës “Zyrtar për Çështje Juridik Administrative” në Drejtorinë e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillim Rural në Komunën e Vushtrrisë e parashtruar nga ankuesi më datë 15.10.2020; E-mailin nga Bislim Dushi për ankuesin datë 04.11.2020; E-



mailin e datës 04.11.2020 nga ankuesi për Raport Specialistik i datës 30.09.2020, 22.05.2020; Kërkesë për transferim të përkohshëm në një pozitë që ka më pak përgjegjësi e parashtruar nga ankuesi më datë 05.02.2020; Raport Mjekësor datë 04.01.2019; Shkresa e datës 22.10.2020 nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë për Udhëheqësin e Personelit; Formulari për ankesë apo kërkesë e datës 14.09.2020 nga ankuesi; Raport Specialistik i datës 07.02.2020; Akt Emërimi i ankuesit i datës 10.03.2014; Vendimi me Nr. 128/20 i datës 10.02.2020 i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë; Paitim për transferim në pozitën Zyrtar për Çështje Juridike në DEBPZHR e datës 05.02.2020 nga Përshkrimi i detyrave të punës i pozitës Zyrtar për Çështje Juridike Administrative datë 10.03.2014; Mendimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë për E-,mailin e datës 02.06.2020 nga E-mailin e datës 01.12.2020 nga Bislim Dushi për ankuesin; E-mailin e datës 01.12.2020 nga ankuesi për EEG raport i datës 12.02.2020; Raport Specialistik i datës 26.10.2020; Raport i Kontrollit Cilësor i datës 12.02.2020, 22.05.2020, 30.09.2020, 12.03.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.12.2019 dhe 20.12.2018 për ankuesin; Kërkesë për pushim vjetor nga ankuesi e datës 16.12.2020 dhe 01.07.2019 dhe Përgjigje në ankesë e datës 30.12.2020 nga Komuna e Vushtrrisë dhe E-mail i datës 08.01.2021 nga menaxheri i personelit i cili ka dërguar Akt emërin dhe përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin për pozitën “Zyrtar për çështje juridike-ligjore”.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa lejuar sepse:

Ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 10.03.2014 ka qenë i punësuar në pozitën “Zyrtar për Çështje Juridike Administrative” në Drejtorinë e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Vushtrrisë, mirëpo pas një aksidenti trafiku që ka pësuar duke u bazuar në raportet mjekësore dhe për shkak të gjendjes shëndetësore, ankuesi dhe Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural më datë 05.02.2020, tek Kryetari i Komunës së Vushtrrisë kanë parashtruar kërkesë për transferim të përkohshëm në një pozitë që ka më pak përgjegjësi.

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë më datë 10.02.2020 ka nxjerr Vendim me Nr. 128/2020, me të cilin ankuesi ricaktohet nga pozita “Zyrtar për Çështje Juridike Administrative në Drejtorinë e Ekonomisë, Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në pozitën “Zyrtar Ligjor” në Qendrën për Shërbim me Qytetar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshjës administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht deklarin e ankuesit se me datë 05.02.2020 ka bërë kërkesë për transferim të përkohshëm tek Kryetari i Komunës së Vushtrrisë. Kryetari i Komunës së Vushtrrisë me datën 10.02.2020 me numër protokoll 128/20 i cili vendim në Këshillën Juridike e udhëzon palën se nëse pala është i pakënaqur me vendimin e datës 10.02.2020 ka të drejtë ankese në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në afat prej 30 ditësh bazuar në nenin 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.



05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ku përcaktohet se: "Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës", andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 09.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.409/2020, datë 19/01/2021

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*

Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vushtrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.